



Бр/№. _____
Скопје/Shkup _____ година/viti

PLAN VJETOR PËR VLERËSIMIN E RREZIKUT NGA KORRUPSIONI NË NDËRMARRJEN PUBLIKE PËR RRUGË SHTETËRORE PËR VITIN 2022

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore duke vepruar sipas Konkluzionit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut me nr. 41-17/55 të datës 28.06.2021 miratoi këtë Plan ç[r] vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit, ku detyra kryesore do të jetë njohja në kohë e rreziqeve të korrupsionit dhe propozimi i masave të duhura për eliminimin e rreziqeve dhe do të jetë udhërrëfyes për aktivitetet e mëtejshme që Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do të ndërmarrë në luftën kundër korrupsionit.

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore, si institucion që kryen punë me interes publik, synon të krijojë një sistem masash që do të mundësojnë luftimin e korrupsionit dhe identifikimin e shkaqeve, kushteve dhe faktorëve që mundësojnë identifikimin e tij.

Në të njëjtën kohë, interesi publik, siç përcaktohet në Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, paraqet “mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe qytetarit të njohura nga e drejta ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, parandalimi i rreziqeve për shëndetin, mbrojtjen dhe sigurinë, mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës, mbrojtjen e pronës dhe lirinë e tregut dhe sipërmarrësisë, sundimin e ligjit dhe parandalimin e krimit dhe korrupsionit.

Nën korrupsion, në kuptimin e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, kuptohet keqpërdorimi i detyrës, autorizimit publik, detyrës zyrtare ose pozitës për realizimin e një përfitimi, drejtpërdrejt ose përmes ndërmjetësuesit, për veten ose për një tjetër, pra duke pasur parasysh se korrupsioni kërcënon të drejtat e qytetarëve, e bën drejtësinë të pamundur, varfëron shoqërinë dhe cenon shtetin ligjor, është e nevojshme që lufta kundër korrupsionit të jetë një detyrim i përhershëm i çdo të punësuarit në Ndërmarrje Publike për Rrugë Shtetërore.

Është detyrë e të gjithë të punësuarve që të veprojnë në përputhje me kushtetutën, ligjet, të demonstrojnë një shkallë të lartë integriteti në punën e tyre, të njohin format e korrupsionit dhe të kenë aftësinë për të kundërshtuar korrupsionin.

Me këtë plan përforcohen kapacitetet dhe vendoset një sistem i sinkronizuar për funksionimin efikas të institucionit kundër korrupsionit, për rikthimin e besimit të qytetarëve dhe për një shoqëri të pastër nga korrupsioni, përmes synimeve dhe aktiviteteve të mëposhtme:

1. Përforcimi i integritetit të të punësuarve në NPRRS

Theks i veçantë në luftën kundër korrupsionit i kushtohet promovimit të integritetit personal dhe profesional të të punësuarve nga të cilët pritet gjatë kryerjes së detyrave të punës të zbatojnë njohuritë e duhura, kapacitetet etike, ndershmërinë dhe të punojnë në favor të interesit publik dhe të rrisin besimin e publikut.





Termi integritet nënkupton kryerjen ligjore, të pavarur, të paanshme, të përgjegjshme etike dhe transparente të punës me të cilën të punësuarit mbrojnë reputacionin e tyre dhe reputacionin e ndërmarrjes.

Termi integritet që në vetvete përfshin integritetin individual dhe institucional.

Integriteti individual nënkupton një qëndrim personal ndaj çështjeve të korrupsionit, konfliktit të interesit, interesit publik dhe aftësisë për të ndërtuar rezistencë.

Integriteti institucional nënkupton rezistencë ndaj korrupsionit dhe nënkupton një sistem të vendosur politikash, standardesh, mekanizmash dhe procedurash që ulin rrezikun e sjelljeve korruptive nga ana e të punësuarve, si dhe i motivojnë ata për një marrëdhënie të ndershme dhe profesionale gjatë kryerjes së detyrave të tyre të punës.

Ndërmarrja publike do të punojë në vazhdimësi në përfundimin e integritetit në nivel personal dhe institucional, me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e besimit të publikut.

Të punësuarit në ndërmarrje janë të detyruar të respektojnë dhe zbatojnë rregullativat ligjore, aktet nënligjore, procedurat e brendshme, me ndërgjegje, përgjegjësi, profesionalizëm dhe paanshmëri. Të punësuarit duhet të sillen në mënyrë etike, pavarësisht nëse janë në punë apo jo. Vetëm me sjellje profesionale, ligjore dhe etike do të forcohet integriteti i të punësuarve, duke kontribuar kështu në eliminimin e mundësisë së paraqitjes së korrupsionit.

2. Respektimi i kodit

Çdo i punësuar në një ndërmarrje publike duhet të ketë një shkallë të lartë njohjeje të kodeve etike.

Kodi për nëpunësit administrativ si dhe Kodi i sjelljes së të punësuarve në Departamentin për pagesë të taksës rrugore dhe kontroll, me të cilat janë të njohur të gjithë të punësuarit në ndërmarrje dhe të cilët janë të qashme publikisht në ueb faqen e Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore, janë bazat për sjelljen etike të të gjithë punësuarve. Çdo mosrespektim i kodit nga të punësuarit është shkak për fillimin e procedurës disiplinore.

Kodi për nëpunësit administrativ përcakton standardet etike dhe rregullat e sjelljes së nëpunësve administrativë dhe qëllimi i këtij kodi është të inkurajojë veprim dhe sjelljen e mirë të nëpunësve administrativ dhe të përforcojë besimin e qytetarëve në punën e institucioneve të sektorit publik.

Parimet bazë të funksionimit për të punësuarit në departamentit për pagesë të taksës rrugore dhe kontroll, sipas Kodit, janë:

- Profesionalizmi, ndërgjegjia, ndershmëria dhe përgjegjësia në kryerjen e detyrave dhe detyrimeve të punës në përputhje me Kushtetutën, ligjet, aktet nënligjore, aktet e përgjithshme të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, pa diskriminim apo favorizim dhe pa asnjë lloj interesi personal.

-Përkushtimi në punë

- Ruajtja e reputacionit dhe dinjitetit të tij dhe reputacionit të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore, duke shmangur situatat dhe sjelljet që mund të dëmtojnë interesin ose reputacionin e Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore.

- Shmangia e përdorimit të statusit ose ndikimit për të kënaqur interesat e veta materiale dhe personale, interesat e anëtarëve të familjes së tyre

- Shmangia e çdo lloj sjelljeje etike jokorrekte

- Respektimi i të drejtave dhe dinjitetit të të tjerëve

- Gjatë kryerjes së detyrave të punës, punëtorët nuk duhet të udhëhiqen nga bindjet e tyre politike, interesat personale, financiare dhe nuk duhet t'i keqpërdorin kompetencat e tyre.





Për zbatimin e kodeve nevojitet një qasje sistematike që do të lejojë që Kodet të kuptohen, pranohen dhe zbatohen nga të gjithë të punësuarit në Ndërmarrje Publike për Rrugë Shtetërore.

3. Krverja e një vlerësimi të rrezikut të korrupsionit

Puna në Ndërmarrjen Publike për Rrugë Shtetërore, si në çdo institucion, mund të jetë subjekt i sjelljeve korruptive. Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit do të mundësojë ngritjen e një sistemi parandalues të korrupsionit të bazuar në fakte dhe do të mundësojë përdorimin efektiv të burimeve në dispozicion për të arritur rezultate në luftën kundër korrupsionit. Është e nevojshme të identifikohen qartë kategoritë e punës me rrezikun më të lartë të korrupsionit. Për këto arsye, është e nevojshme të gjendet një mënyrë përmes trajnimit të të punësuarve në fushën e vlerësimit të rrezikut dhe menaxhimit të rrezikut, por edhe përfshirja e Departamentit për auditimit të brendshëm për të gjetur mënyra për të vlerësuar rreziqet kryesore të korrupsionit dhe për të bërë metodologji me propozime të masat për të ulur dhe hequr format e ndryshme të rreziqeve.

Akti ligjor që rregullon menaxhimin e rreziqeve (nga korrupsioni) në sektorin publik është Ligji për Parandalimin e Korrupsionit, i cili duhet të jetë udhërrëfyes në Vlerësimin e rrezikut të korrupsionit.

4. Futja e procedurave të përshkruara për proceset e punës në NPRRSH

Përforcimi i integritetit të institucioneve është një temë veçanërisht e rëndësishme si për procesin e reformës në administratën publike, ashtu edhe për parandalimin e korrupsionit.

Përkatësisht, për të zbatuar transparencën në punën e institucionit, përgjegjësinë, llogaridhënien, punën etike të të punësuarve apo administratën profesionale dhe të depolitizuar dhe realizimin e një administrate cilësore në të cilën korrupsioni është ulur në nivelin minimal, duhet të ketë procedura të shkruara për punë në proceset e punës së Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore në çdo segment dhe fushë të punës.

Në Ndërmarrjen Publike për Rrugë Shtetërore ka procedura të përshkruara, të cilat duhet të përditësohen dhe përmirësohen vazhdimisht sipas proceseve të punës së njërive organizative në ndërmarrje, si dhe monitorimi i veprimeve të të gjithë të punësuarve.

Në këtë mënyrë do të eliminohen rreziqet e sjelljeve korruptive të punëtorëve në Ndërmarrjen Publike

5. Profesionalizimi, departamentizimi dhe depolitizimi i të punësuarve

Një administratë profesionale e departizuar, e bazuar në merita është themeli në luftën kundër korrupsionit. Gjatë punësimit në ndërmarrjen publike duhet të respektohen në mënyrë të duhur të gjitha procedurat dhe rregullativat ligjore, veçanërisht aktet ligjore dhe nënligjore sipas të cilave bëhet punësimi dhe avancimi i të punësuarve në Ndërmarrjen Publike për Rrugë Shtetërore, përkatësisht Ligji për Nëpunësit Administrativ, Ligji për të Punësuarit në Sektorin Publik, Ligji për Ndërmarrjet Publike dhe Ligji për Marrëdhëniet Pune. Është gjithashtu e nevojshme të vendoset një procedurë uniforme për zgjedhjen dhe emërimin e pozitave udhëheqës, bazuar në parimet e meritës, qasjes së barabartë në vendin e punës në kushte të barabarta, përfaqësimit adekuat dhe të drejtë dhe barazisë gjinore.

Detyrat e punës duhet të kryhen pa ndikim të politikës, pa ndikim të bindjeve personale, politike dhe interesave financiare, me respekt të vazhdueshëm të qëllimeve, reputacionit dhe integritetit të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore.





6. Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarve

Të punësuarit në Ndërmarrjen Publike për Rrugë Shtetërore duhet të plotësojnë kërkesat e larta në lidhje me llojin e arsimit, kualifikimet, reputacionin, kompetencat personale dhe profesionale gjatë punës dhe për këto arsye forcimin e integritetit të të punësuarve dhe ndërtimin e kulturës së intolerancës ndaj korrupsionit, përmes ndjekjes së trajnimeve në fushën e luftimit të korrupsionit, Ligjit për qasje të lirë në informacionin publik dhe gjetjen e mundësive dhe trajnimeve të duhura në fushën e integritetit dhe zhvillimit personal, të cilat do t'u ofrohen të punësuarve, si dhe inkurajim i të punësuarve që të drejtohen vet të tregojnë interes për gjetjen dhe ndjekjen e trajnimeve që synojnë sigurimin e rritjes së efikasitetit në punë.

Trajnimet që do të kryhen mund të jenë gjenerike, përmes MSHIA, si dhe të specializuara dhe do të zhvillohen për të gjithë punësuarit në Ndërmarrjen Publike për Rrugë Shtetërore, ashtu që të njëjtit janë të detyruar që specialist të përvetësohen për punën që e realizojnë në vendin e punës së tyre, përvetësimi i aftësive dhe njohurive përmes programeve të organizuara.

7. Kontrolli dhe mbikëqyrja e përforcuar e furnizimit publik

Analiza e furnizimit publik nga viti i kaluar financiar. Përforcimi i kapaciteteve me kuadër të kualifikuar dhe të trajnuar për zbatimin e furnizimeve publike, nëpërmjet realizimit të trajnimeve për furnizime publike për të gjithë të punësuarit në Sektorin për furnizim publik dhe për numrin më të madh të të punësuarve të cilët marrin pjesë në Komisionet për furnizim publik.

Funksionimi i plotë i parimeve bazë të furnizimit publik: transparenca, konkurrueshmëria, trajtimi i barabartë i operatorëve ekonomikë, mosdiskriminimi, ligjshmëria, përdorimi ekonomik, efikas, efektiv dhe racional i mjeteve buxhetore, përpjekja për të marrë ofertën më të mirë në kushtet më të volitshme, si dhe llogaridhënien për mjetet e shpenzuara te furnizimet.

8. Përforcimi i parimit të transparencës në punë

Me afrimin e shërbimeve me qytetarët, rritet transparenca, efektiviteti, efikasiteti, qashmëria, kontrolli i ndërmarrjes dhe forcohet besimi i qytetarëve, që është baza në luftën kundër korrupsionit.

Zbatimi konsekuent i Ligjit për Qasje të Lirë në Informata Publike me publikimin e informatave nga Ligji për Qasje të Lirë në Informata Publike në ueb faqen e institucionit dhe zbatimin me kohë të obligimeve sipas të njëjtit ligj. Për këtë qëllim, Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore ka caktuar një person zyrtar për ndërmjetësim me informacionet të karakterit publike në Ndërmarrjen Publike për Rrugë Shtetërore, të dhënat e të cilit janë në dispozicion të publikut në ueb faqen e ndërmarrjes.

Për një luftë efektive dhe efikase kundër korrupsionit, institucionet duhet të kenë edhe mekanizma efikasë dhe efektivë për menaxhimin e procesit të ndjekjes dhe monitorimit të situatës me korrupsionin, si dhe për situatat në lidhje me konfliktin e interesit, integritetin dhe pranimin e dhuratave, si aspekte që janë në lidhje të drejtpërdrejtë me korrupsionin. Për këtë qëllim, Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore ka caktuar një person të autorizuar për pranimin e fletëparaqitjeve të dorëzuara me qëllim të raportimit të brendshëm të mbrojtur në





Ndërmarrjen Publike për Rrugë Shtetërore, të dhënat e së cilës janë në dispozicion të publikut në ueb faqen e ndërmarrjes.

9. Detyrim për zbatimin e planit për parandalimin e korrupsionit.

Zbatimi i politikës për integritet dhe parandalim të korrupsionit është përgjegjësi e të gjithë të punësuarve në Ndërmarrje Publike për Rrugë Shtetërore. Miratimi i këtij plani për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit imponon detyrim për të gjitha njësitë organizative. Për realizimin e obligimeve nga Plani dhe me aktivitete të koordinuara të të gjitha njësive organizative në Ndërmarrjen Publike për Rrugë Shtetërore, mund të ballafaqohemi me korrupsionin si fenomen negativ shoqëror.

Zbatimi i Planit për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit është përgjegjësi e të gjithë udhëheqësve të njësive organizative në Ndërmarrjen Publike për Rrugë Shtetërore, të cilët duhet të njoftojnë të punësuarit me planin për parandalimin e korrupsionit.

Plani vjetor i vlerësimit të rrezikut të korrupsionit do të publikohet në faqen e internetit të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore.

Drejtor
Ejup Rustemi

